




KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0005630-6/26, dt. 10.02.2026
Mitrovicë



Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, dhe nenit 51, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); neneve 13 paragrafi 1, nenparagrafi 1.4 dhe 61, paragrafi 2, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 13, paragrafët: 1 dhe 3, si dhe nenit 14, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komunë dhe komiteteve tjera; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 10.02.2026, sjell këtë:

VENDIM

Për formimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

1. Miratohet Vendimi për formimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
2. Komiteti i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është në këtë përbërje:
 - 2.1 Lavdim Zneli,
 - 2.2 Jeton Zeneli,
 - 2.3 Rozana Peci,
 - 2.4 Nerxhivane Sadiku, dhe
 - 2.5 Bcsfort Xhemajli.
3. Kompetencat dhe aktivitetet e komitetit janë të përcaktuara me Rregulloren Komunale Nr. 01/2009 Për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës, si në vijim:
 - 3.1 Monitoron implementimin e shërbimeve për kujdesin primar shëndetësor në Komunë;
 - 3.2 Shqyrton projekt-buxhetin për shëndetësi dhe jep propozime për Komitetin për Politikë dhe Financa;
 - 3.3 Shqyrton planin vjetor të punës të përgatitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Mirëqenies Sociale;
 - 3.4 Monitoron zbatimin e dispozitave në lidhje me grupet e varfra të njerëzve, invalidëve të luftës, viktimave e dhunës familjare, fëmije të mitur, të pastrehëve, të rikthyerve dhe pensionistëve;
 - 3.5 Këshillon dhe konsultohet me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Drejtorinë e Mirëqenies Sociale;
 - 3.6 Ndhmon në caktimin e fondeve për strehim;
 - 3.7 Harton propozimet për strategjitë strchuese me qira, duke përfshirë ndërtimin e shtëpive, dhe prioritetet kryesore përkatëse për renovime ndërtimesh dhe ndihma financiare; dhe
 - 3.8 Shqyrton hollësishtëm propozim-planet strehuese.
4. Zgjedhja e kryesuesit të komitetit bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të komitetit. Në rast të mungesës së kryesuesit, mbledhjen e kryeson anëtari më i vjetër i komitetit.
5. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i dorëzon Kuvendit të Komunës raportin vjetor të punës së tyre për shqyrtim dhe miratim.
6. Mandati i anëtarëve të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është i lidhur me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
7. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI

Dorëzohet: 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
1 x 1 MAPL-së
1 x 1 Arkivit
Kopje: Kryetarit të Komunës
Anëtarëve të komitetit